

NDJEKJA E PUNËS SË KOMISIONIT SHTETËROR PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT

RAPORT TREMUJOR NR. 1
TETOR - DHJETOR 2016



**NDJEKJA E PUNËS SË KOMISIONIT SHETËROR PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT: RAPORT
TREMUIJOR NR. 1 PËR PERIUHDHËN PREJ 01 TETOR DERI MË 31 DHJETOR 2016**

Botues: Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (QMBN)

Për botuesin:

Aleksandar Kërzhhalovski, drejtor i parë ekzekutiv

Gonce Jakovleska, drejtore ekzekutive

Kontakt:

QMBN, adresa: rr. "Nikolla Parapunov" nr. 41a; fahu postal 55, 1060 Shkup;

tel.+389/2/3065-381; faks; +389/2/3065-298; posta elektronike: mcms@mcms.mk; ueb-faqja: mcms.mk

Scribd: <http://www.scribd.com/people/documents/2996697>;

SlideShare http://www.slideshare.net/mcms_mk

Facebook: <http://www.facebook.com/mcms.mk>;

Twitter: http://twitter.com/mcms_mk

CIP - Katalogizacija vo publikacija

Nacionalna i univerzitetska biblioteka «Св. Климент Охридски», Скопје

35.072.2:343.352(497.7)»2016*10/*12»

СЛЕДЕЊЕ на работата на Државната комисија за спречување на корупцијата : квартален извештај бр.

1 : октомври-декември 2016 г. - Скопје : Македонски центар за меѓународна соработка (МЦМС), 2017.

- 33 стр. : граф. прикази ; 30 см

Публикацијата е во рамките на проектот: «Следење на работата на Државната комисија за спречување на корупцијата од страна на јавноста». - Библиографија: стр. 32

ISBN 978-608-4681-84-7

а) Државна комисија за спречување корупција - Транспарентност - Македонија - 2016*10/*12

COBISS.MK-ID 103585034

Të gjitha të drejtat janë të mbrojtura. Reprodurimi, kopjimi, transmetimi apo përkthimi i cilës do pjesë të këtij publikimi mund të bëhet vetëm me këto kushte: me leje paraprake të botuesit, për qëllim të citimit të një analize në libër dhe me kushte të paraqitura në vijim.

E drejta autoriale e këtij publikimi është e mbrojtur, por publikimi mund të ribotohet në çfarëdo mënyre, pa pagesë, për qëllime edukative. Për kopjim në kushte të tjera, për shfrytëzim në publikime të tjera apo për përkthim dhe adaptim, duhet të sigurohet leje paraprake nga botuesi.

Në formë elektronike, publikimi është në dispozicion në www.mcms.mk



Përgatitja e këtij publikimi është në kuadër të projektit "Ndjekja e punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit nga ana e publikut", i përkrahur nga Ambasada Britanike në Shkup. Mendimet dhe qëndrimet e paraqitura në këtë publikim janë të autorëve.

PËRMBAJTJA

| | |
|---|----|
| 1. HYRJE | 5 |
| 2. METODOLOGJIA | 6 |
| <u>2.1. INSTRUMENTET E HULUMTIMIT</u> | 6 |
| 2.1.1. PËRPUNIMI DHE PARAQITJA E REZULTATEVE | 6 |
| 3. PERFORMANCA | 8 |
| <u>3.1. KRIJIMI I STRATEGJIVE DHE POLITIKAVE KUNDËR KORRUPSIONIT</u> | 8 |
| <u>3.2. MBIKËQYRJE DHE KONTROLL</u> | 9 |
| <u>3.3. BASHKËPUNIM DHE EDUKIM</u> | 15 |
| 4. TRANSPARENÇË | 17 |
| <u>TRANSPARENCA DE JURE</u> | 17 |
| <u>TRANSPARENCA DE FAKTO</u> | 19 |
| 5. LLOGARIDHËNIE | 23 |
| <u>5.1. MENDIMI I QYTETARËVE PËR KSHPK</u> | 24 |
| 6. KONKLUSIONE | 28 |
| 7. REKOMANDIME | 30 |
| BIBLIOGRAFI | 31 |

PROJEKTI “NDJEKJA E PUNËS SË KSHPK”



Ky projekt ka për qëllim të kontribuojë përnjë transparencë dhe llogaridhënie më të madhe, si dhe për forcimin e vetëdijes publike për rezultatet e punës së KSHPK. Nëpërmjet këtij projekti ndiqet zbatimi i obligimeve ligjore dhe niveli i transparencës dhe llogaridhënies së KSHPK, si dhe kontributi i tij në luftën kundër korrupsionit në Republikën e Maqedonisë.

Nëpërmjet raporteve tremujore, qytetarët dhe palët e tjera të interesit në mënyrë të rregullt do të marrin informata të përgjithshme për rezultatet nga puna e KSHPK. Për vetë KSHPK, përfitim nga ndjekja e jashtme paraqet fitimi i një vlerësimi të jashtëm për punën e vet.

Për nevojat e projektit, QMBN dhe KSHPK vendosën një bashkëpunim, i cili ka për qëllim dhënien tremujore të të dhënave për nevojat e analizave në kuadër të projektit.

Ky projekt realizohet nga shtatori 2016 deri në prill 2018 nga ana e Qendrës Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (QMBN) dhe është i përkrahur nga Ambasada Britanike në Maqedoni.

1. HYRJE

Në pajtim me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK) është institucion i mëvetësishëm dhe i pavarur kundër korrupsionit. Mes tjerash, kompetencat e tij janë të lidhura me procesin e krijimit të politikave, ndjekje dhe mbikëqyrje, si dhe bashkëpunim me organe të tjera shtetërore me qëllim të parandalimit të korrupsionit.

Projekti “Ndjekja e punës së KSHPK” ka për qëllim të kontribuojë drejt transparencës dhe llogaridhënies më të madhe, si dhe për forcimin e vetëdijes publike për rezultatet nga puna e KSHPK. Nëpërmjet projektit ndiqet realizimi i obligimeve ligjore dhe niveli i transparencës dhe llogaridhënies së KSHPK, si dhe kontributi i tyre në luftën kundër korrupsionit në Republikën e Maqedonisë.

Rezultatet nga ndjekja do të publikohen në raportet tremujore. Qëllimi i këtyre publikimeve është që qytetarët dhe palët e tjera të interesit në vazhdimësi të marrin informacione për rezultatet nga puna e KSHPK. Për vetë KSHPK përfitimi nga ndjekja e jashtme është të marrë një vlerësim të pavarur për punën e vet. Çdo raport do të përmbajë edhe konkluzione për periudhën përkatëse. Ato KSHPK do të mund t'i shfrytëzojë për dëshmimin e arritjeve dhe për përmirësimin në fushat në të cilat është identifikuar ndonjë dështim.

2. METODOLOGJIA

Metodologjia e cila u zbatua për këtë raport bazohet në përvojat pozitive në ndjekjen e punës së trupave kundër korrupsionit nga ana e Qendrës për Studimin e Demokracisë (QSD) nga Bullgaria dhe nga përvoja e QMBN në ndjekjen e transparencës së institucioneve.

Në këtë raport është përfshirë ndjekja e punës së KSHPK në periudhën nga tetori deri në dhjetor 2016.

2.1. INSTRUMENTET E HULUMTIMIT

Metodologjia e cila zbatohet në raportet bazohet në matricën e indikatorëve të përgatitur në bashkëpunim me QSD.

Tre grupet e indikatorëve të cilat ndiqen në këtë raport janë:

1. **Indikatorë të performancave (IP)** - japin përgjigje se a i plotëson dhe sa i plotëson KSHPK kompetencat të cilat i janë dhënë me Ligjin për parandalimin e korrupsionit, me Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesave dhe me Ligjin për mbrojtje të informatorëve;
2. **Indikatorë të transparencës (IT)** - japin përgjigje për qasje deri te informatat lidhur me punën e KSHPK deri te publiku;
3. **Indikatorë të llogaridhënies (ILL)** - japin përgjigje për nivelin e arritjeve të llogaridhënies së ashtuquajtur vertikale para institucioneve para të cilat përgjigjet dhe llogaridhënien horizontale ndaj të gjitha palët e tjera të interesit para të cilave nuk ka përgjegjësi formale (institucione të tjera, sektori qytetar, mediet, bashkësia e biznesit etj.).

Si pikënisje në përcaktimin e indikatorëve është shfrytëzuar Ligji për parandalimin e korrupsionit, Ligji për parandalimin e konfliktit të interesave dhe Ligji për mbrojtje të informatorëve, si tre ligje në bazë të të cilëve vepronte në mënyrë parësore KSHPK.

Matrica e indikatorëve është në dispozicion në ueb-faqen e QMBN.

2.1.1. PËRPUNIMI DHE PREZANTIMI I REZULTATEVE

Rezultatet e prezantuara bazohen në përpunimin e informacioneve të fituara nga analiza e të dhënave dytësore në dispozicion në internet, nga të dhënat e fituara nga KSHPK dhe nga hulumtimi me popullatën.

Për prezantim vizual të arritjeve të indikatorëve janë përdorur tri ngjyra, siç vijon:

**PËRMBUSHJE E TËRËSISHME E INDIKATORËVE
(LIGJI ZBATOHET NË TËRËSI)**

**PËRMBUSHJE E PJESSHME E INDIKATORËVE
(KSHPK VEPRON SIPAS LIGJIT, POR PAMJAFTUESHËM)**

**MOSPËRMBUSHJE E TËRËSISHME E INDIKATORËVE
(KSHPK NUK VEPRON SIPAS KOMPETENCAVE TË PËRCAKTUARA NË LIGJ)**

**INDIKATORË PËR TË CILËT NUK EKZISTON KOMPETENCË TË
PËRCAKTUAR ME LIGJ**

Pasi që **“ngjyrosja” e indikatorëve është e lidhur me nivelin e zbatimit të obligimeve të përcaktuara me ligj**, indikatorët për të cilët nuk ekziston baza ligjore janë lënë pa këtë kategorizim. Shembujt janë de facto indikatorë për transparencë, sepse ata janë definuar si një praktikë e dëshiruar të cilën KSHPK duhet ta zbatojë. Ngjyra e portokalltë ka të bëjë edhe me situatën kur KSHPK nuk ka vepruar për shkak të mosekzistimit të kërkesës konkrete për veprim sipas një kompetence të përcaktuar me ligj, si dhe kur s’ka pasur bazë për nisjen e iniciativës për ndërmarrjen e aktiviteteve dhe masave të përcaktuara me ligje. Pasi që **“ngjyrosja” e indikatorëve është e lidhur me nivelin e realizimit të obligimeve të përcaktuara me ligj**, indikatorët për të cilët nuk ekziston bazë ligjore janë lënë pa këtë kategorizim, gjegjësisht janë prezantuar me ngjyrë të përhitur.

Për vlerësimin e nivelit të rasteve të ngritura të korrupsionit apo të konfliktit të interesave, është përdorur modeli për klasifikim, i zhvilluar në analizën **“A jep rezultate modeli kundër korrupsionit në Maqedoni?”**.¹ Modeli në nivel të korrupsionit ka parasysh dy parametra: pozita në sistemin politik apo në administratën publike në të cilën gjendet një person i zgjedhur dhe i emëruar i akuzuar për korrupsion dhe vlerësimi i shumës së parave e cila është keqpërdorur. Për nevojat e kësaj analize modeli është përshtatur me përcaktimin e **tre niveleve të korrupsionit: i lartë, i mesëm dhe i ulët**. Klasifikimi detal i përdorur për nevojat e raporteve tremujore mund të gjendet në Raportin për Arritjet e KSHPK në periudhën prej vitit 2006 deri në vitin 2015.

Pjesë e këtij raporti janë rezultatet nga **anketa telefonike me popullatën**, e cila kishte për qëllim ta vlerësojë perceptimin e qytetarëve për punën e KSHPK. Anketa u realizua në shkurt 2017, me një ekzemplar prej 1.300 të anketuarve.

Sa u përket termeve të përdorur, duhet të theksohet se gjatë tekstit përdoren terme për persona të zgjedhur dhe të emëruar, me të cilët janë përfshirë persona të zgjedhur dhe të emëruar, persona zyrtar apo persona përgjegjës në ndërmarrjet publike dhe persona të tjerë juridik, të cilët disponojnë me kapital shtetëror dhe të cilët i nënshtrohen Ligjit për parandalimin e korrupsionit, Ligjit për konflikt të interesave dhe ligjeve të tjera, në bazë të të cilëve vepron KSHPK.

3. PERFORMANCA

Indikatorët për performanca japin përgjigje se a i përmbush dhe sa i përmbush KSHPK kompetencat të cilat i janë dhënë me Ligjin për parandalimin e korrupsionit, me ligjin për parandalimin e konfliktit të interesave dhe me Ligjin për mbrojtje të informatorëve. Indikatorët janë grupuar sipas katër grupeve bazë të kompetencave nëpërmjet të cilave KSHPK mund ta zbatojë preventivën e vet dhe rolin represiv në luftën kundër korrupsionit: krijimi i politikave kundër korrupsionit, mbikëqyrje dhe kontroll, bashkëpunim dhe edukim dhe informim.

3.1. KRIJIMI I STRATEGJIVE DHE POLITIKAVE KUNDËR KORRUPSIONIT

Ç'BËN KSHPK PËR TË KONTRIBUAR DREJT KRIJIMIT TË STRATEGJIVE DHE POLITIKAVE KUNDËR KORRUPSIONIT?

Merr pjesë në krijimin dhe ndryshimet e ligjeve kundër korrupsionit

Jep mendime për propozim-ligje, me qëllim që të mos sillen ligje të cilat në vete do të kenë dispozita me të cilat mund të shfaqet rreziku nga korrupsioni

E ndjek dhe e zbaton Programin Shtetëror për Preventivë dhe Represion të Korrupsionit dhe Preventivë dhe Ulje të Dukurisë së Konfliktit të Interesave (2016-2019)

ÇFARË KANË REALIZUAR NË PERIUHDËN NGA 1 TETORI DERI MË 31 DHJETOR 2016?

| INDIKATOR | TETORI - DHJETOR 2016 |
|--|---|
| IP 2 DHËNIA E MENDIMEVE PËR PROPOZIME ME VLERË PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT | Me kërkesë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, KSHPK ka përgatitur komente rreth propozimit të ligjit për ndryshimin e Ligjit për punë të brendshme. |
| IP3 ZBATIMI I PROCESIT TË KONTROLLIT KUNDËR KORRUPSIONIT NË LEGJISLATURË | KSHPK në periudhën e raportimit është në proces të përgatitjes së planit vjetor për zbatimin e procesit të kontrollit kundër korrupsionit në legjislaturë të ligjeve që veç më janë sjellë në vitin 2017. |

3.2. MBIKËQYRJE DHE KONTROLL

Cilat masa dhe aktivitete i ndërmerr KSHPK për të kryer mbikëqyrje dhe kontroll të përcaktuar me Ligjin për parandalimin e korrupsionit, me Ligjin për pengimin e konfliktit të interesave dhe me Ligjin për mbrojtjen e raportuesve?

ngrit iniciativa para institucioneve të tjera kompetente, në rast se konstatohet dyshim për keqpërdorim të mjeteve buxhetore dhe mjeteve të fondeve publike për fushatë zgjedhore ose çfarëdo aktiviteti politik

ndërmerr aktivitete për raste kur konstaton se ekzistojnë privilegje apo diskriminim sa u përket marrëveshjeve, furnizimeve publike dhe kontratave të tjera pas zgjedhjeve;

u jep mendim institucioneve shtetërore për ndryshime të dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit gjatë zgjedhjeve

ngrit iniciativa për shkarkimin e personave të zgjedhur ose të emëruar

ngrit iniciativa për zbatimin e procedurës për ndjekje penale të personave të zgjedhur ose të emëruar

evidenton dhe ndjek ndryshime të gjendjes pronësore të personave të zgjedhur dhe të emëruar

mirëmban regjistrin në të cilin duhet të inkuadrohen të gjithë personat e zgjedhur dhe të emëruar

e evidenton fitimin e aksioneve dhe pjesëmarrjeve në kapital të personave të zgjedhur dhe të emëruar, në rast se aksionet janë të personave juridik mbi punët e të cilëve bën kontroll

vepron në bazë të ankesave të qytetarëve të pakënaqur nga vendimi i sjellë në bazë të kompetencave diskrecionale dhe të cilët llogarisin se vendimi është sjellë për shkak të korrupsionit

Постапува по претставки на граѓаните кои поднеле пријава незадоволни од одлуката донесена врз основа на дискрециско овластување и кои сметаат дека одлуката е донесена поради корумпираност

ÇFARË KA REALIZUAR KSHPK NË PERIUdhËN PREJ 1 TETORIT DERI MË 31 DHJETOR 2016?

| INDIKATOR | TETORI - DHJETOR 2016 |
|---|---|
| <p>IP 6</p> <p>VEPRIME PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT NË PROCESIN ZGJEDHOR</p> | <p>Më 11 dhjetor 2016 u mbajtën zgjedhje të parakohshme parlamentare në të cilat morën pjesë 11 subjekte politike, gjashtë parti politike dhe pesë koalicione. Në bazë të marrëveshjes politike mes katër partive, më 2 shtator u zgjodh qeveria kalimtare, me të cilën gjë specifike ishte se periudha zgjedhore filloi me zgjedhjen e qeverisë kalimtare. Fushata zgjedhore zgjati nga 21 nëntori deri më 9 dhjetor 2016.</p> <p>Në periudhën zgjedhore, organet shtetërore, institucionet dhe individët mund të kërkonin mendim nga KSHPK se a mund të ndërmarrin aktivitete të caktuara me shfrytëzimin dhe pasjen në dispozicion të mjeteve buxhetore në periudhën zgjedhore. Për shembull, ndonjë institucion në rast se nuk është i sigurt se mund të zbatojë një procedurë të caktuar për punësim apo furnizim publik, mund të bëjë kërkesë deri te KSHPK për mendim se a është një veprim i caktuar në pajtim me ligjin.</p> <p>Në periudhën prej 07.09.2016 deri më 31.12.2016, KSHPK ka hapur 1.548 lëndë për shqyrtim të zbatueshmërisë së dispozitave të Ligjit për parandalimin e korrupsionit, nga të cilët 1.526 me kërkesa për mendim nga institucione shtetërore për zbatimin e dispozitave të Ligjit për parandalimin e korrupsionit, 11 mbi bazë të denoncimeve të partive politike, 1 në bazë të denoncimit nga një shoqatë, 6 në bazë të denoncimit nga një person juridik (ministri dhe komuna), 2 të personave fizik dhe 2 lëndë janë formuar me iniciativë të vetë KSHPK.</p> <p>Mendimet e kërkuara kishin lidhje me procedurat për punësim në kohë të pacaktuar dhe të caktuar, me procedurat për furnizime publike, me procedurat për dhënien me qira të pronës në pronësi shtetërore dhe lloje të tjera të pasjes në dispozicion mjete buxhetore në nivel qendror dhe lokal.</p> <p>Lëndët e formuara në bazë të denoncimeve të partive politike, shoqatave, personave fizik dhe juridik me iniciativë të vet gjatë procesit zgjedhor (22), kanë të bëjnë me dyshime për shkelje të kryera të dispozitave të Ligjit për parandalimin e korrupsionit – kapitulli i dytë “Korrupsioni dhe politika” dhe nenet 8-a dhe 8-b të Kodit Zgjedhor, të cilët e rregullojnë shfrytëzimin e mjeteve buxhetore në periudhën zgjedhore.</p> <p>Nga këto 22 lëndë si karakteristike veçohen dy. Në lëndën e parë, KSHPK nga institucionet kompetente kërkoi të ndërmarrin masa për veprimtari të paligjshme të personave zyrtar të ndërmarrjeve publike dhe ndaj një kryetari komune. Personat zyrtar dyshohet se gjatë fushatës së filluar zgjedhore për qëllime dhe nevoja partiake të një partie politike kanë shfrytëzuar të punësuar në ndërmarrje publike dhe automjete në pronësi të ndërmarrjes publike për transport të materialit zgjedhor, veprim ky kundër ndalesës së vendosur në Kodin Zgjedhor (neni 8-b, alineja 1 dhe 2 dhe neni 8-a alineja 1) dhe në Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit (neni 3 dhe neni 11 alineja 1 dhe 3 dhe neni 13).</p> |

IP 7

NGRITJE TË INICIATIVAVE
PARA ORGANEVE
KOMPETENTE PËR KONTROLL
TË PUNËS FINANCIARE-
MATERIALE TË PARTIVE
POLITIKE

KSHPK veptoi në bazë të një denoncimi të marrë nga një pjesëmarrës në procesin zgjedhor për dyshime për përdorimin e burimeve kundërligjore dhe anonime të financimit nga ana e një partie dhe dhënie rryshfet zgjedhësve¹. Në bazë të denoncimit, KSHPK kërkoi nga Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë të bëjë kontroll detal të punës financiare-materiale nga ana e Drejtorisë për të Hyra Publike dhe kontroll/analizë financiare nga ana e Drejtorisë për Zbulim Financiar kundër një partie politike.

IP 8

NGRITJE E INICIATIVAVE PËR
NISJEN E PROCEDURËS PARA
ORGANEVE KOMPETENTE
PËR SHKARKIM, RIVENDOSJE,
ZËVENDËSIM APO TË MASAVE
TË TJERA TË PËRGJEGJËSISË
TË PERSONAVE TË ZGJEDHUR
APO EMËRUAR, PERSONAVE
ZYRTAR APO PERSONAVE
PËRGJEGJËS NË NDËRMARRJE
PUBLIKE DHE PERSONA
JURIDIK TË TJERË, TË CILËT
DISPONOJNË ME KAPITAL
SHTETËROR

KSHPK ka ngritur tri iniciativa për nisjen e procedurës para organeve kompetente për shkarkim, rivendosje, zëvendësim, ndjekje penale apo të masave të tjera kundër persona të zgjedhur apo të emëruar:

1. Iniciativë për nisjen e procedurës për shkarkimin e drejtorit të shkollës fillore komunale "Nikolla Karev" nga Krusheva, për shkak të plotësimit të pamjaftueshëm të kushteve të përcaktuara me Ligjin për arsim fillor;
2. Iniciativë për shkarkimin e drejtorit të Shkollës Fillore "Përparimi", fshati Çegran, Gostivar, për kryerjen e kompetencave dhe obligimeve publike, sepse ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesave dhe të Ligjit për parandalimin e korrupsionit;
3. Iniciativë për shkarkimin e dekanit të Fakultetit Juridik – Kërçovë, për zbatimin e kompetencave dhe obligimeve publike, sepse ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesave dhe të Ligjit për parandalimin e korrupsionit.

Të tre iniciativat e ngritura, sipas klasifikimit, bëjnë pjesë në nivelin e ulët të korrupsionit.

Nuk ka informata në dispozicion për dëmin nga keqpërdorimi potencial (i buxhetit, i institucionit ku është dëshmuar, i shfrytëzuesve të shërbimeve, i qytetarëve, i cilësisë së punës së institucionit).

IP 9

NGRITJA E INICIATIVËS PËR
NISJEN E PROCEDURËS
PËR NDJEKJE PENALE TË
PERSONAVE TË ZGJEDHUR
DHE TË EMËRUAR,
PERSONAVE ZYRTAR APO
PERSONAVE PËRGJEGJËS
NË NDËRMARRJE PUBLIKE,
INSTITUCIONE PUBLIKE
DHE PERSONAVE TË TJERË
JURIDIK, TË CILËT KANË
NË DISPOZICION KAPITAL
SHTETËROR

Edhe pse KSHPK nuk ka ngritur iniciativa për procedura për ndjekje penale të personave të zgjedhur apo emëruar, personave zyrtar apo personave përgjegjës në ndërmarrje publike, institucione publike dhe personave të tjerë juridik të cilët kanë në dispozicion kapitalin shtetëror, dy procedurat e përmendura nga IP 6 janë procedura për persona të zgjedhur apo të emëruar (ministër dhe kryetar komune)

IP 10

EVIDENTIMI DHE NDJEKJA E FLETËVE ANKETUESE DHE DENONCIMEVE PËR NDRYSHIME TË GJENDJES PRONËSORE TË PERSONAVE TË ZGJEDHUR DHE TË EMËRUAR, TË PERSONIT PËRGJEGJËS NË NDËRMARRJE PUBLIKE, INSTITUCION PUBLIK APO TË NJË PERSONI TJETËR JURIDIK, I CILI KA NË DISPOZICION KAPITALIN SHETËROR

Sipas të dhënave të KSHPK, kanë pranuar:

- 94 fletë anketuese për zgjedhje në funksion;
- 54 fletë anketuese për përfundim të funksionit;
- 84 fletë anketuese për paraqitje të ndryshimeve të gjendjes pronësore.

Sipas të dhënave të gazetave zyrtare të Republikës së Maqedonisë, në të njëjtën periudhë janë publikuar vendime për emërim dhe zgjedhje të 193 personave dhe vendime për përfundim të funksionit për 56 persona. Në pajtim me Ligjin për parandalimin e korrupsionit, të gjithë këta persona kanë obligim të paraqesin fletën anketuese, me të cilën përcaktohet gjendja e pronës gjatë zgjedhjes, gjegjësisht gjatë përfundimit të funksionit.

Gjatë kontrollit të bazës së të dhënave të KSHPK, nga 193 të emëruarve dhe të zgjedhurve të rinj, janë publikuar fletët anketuese të 158 (82%) personave. Për 35 (18%) persona, nuk gjenden fletët anketuese në ueb-faqen. Personat për të cilët nuk ka fletë anketuese janë zgjedhur në funksione në këshilla drejtues, në këshilla mbikëqyrës, në këshilla për ndarjen e çmimeve etj.

Dallimi në numrin e fletëve anketuese të dorëzuara në KSHPK gjatë zgjedhjes në funksion (94) dhe numri i personave të zgjedhur dhe të emëruar sipas të dhënave të publikuara në Gazetën Zyrtare (193), do të thotë se 99 persona nuk kanë dorëzuar fletë anketuese gjatë zgjedhjes së funksionit të ri.

Vazhdojnë të vërehen mangësi në mënyrën e evidentimit dhe publikimit të fletëve anketuese në ueb-faqe. Kështu, për 33 persona të emëruar dhe të zgjedhur janë publikuar nga dy, ndërsa për një person janë publikuar tri fletë anketuese të ndryshme. Numri më i madh i këtyre rasteve (30) ka të bëjë me deputetët e zgjedhur të rinj për të cilët janë publikuar edhe fletët anketuese, të cilat i kanë dorëzuar për funksione të tjera të cilat i kryejnë në këtë çast. Sipas praktikës së deritanishme të KSHPK, pas dorëzimit të fletës anketuese pas përfundimit të funksionit, të dhënat tërhiqen nga ueb-faqja. Gjatë kontrollit të qasjes së fletëve anketuese të personave për të cilët janë publikuar vendime për shkarkim në gazetën zyrtare, për një pjesë të tyre vazhdon të ketë të dhëna në ueb-faqe.

KSHPK deri te gjyqi kompetent ka bërë nëntë kërkesa për ngritjen e procedurës kundërvajtëse për mosdorëzimin e fletës anketuese, apo për ndryshime në gjendjen pronësore. KSHPK deri te Drejtoria për të Hyra Publike ka bërë pesë kërkesa për ngritjen e procedurës për kontrollin e pronës dhe gjendjes pronësore.

Edhe pse në pajtim me Listën me informata të cilën e ka në dispozicion KSHPK, pika 18, e dhëna “emri dhe mbiemri i personave kundër të cilëve është bërë kërkesa” është klasifikuar si informatë e karakterit publik, këto informata nuk u dorëzuan nga ana e KSHPK.

IP 11**RASTE TË NGRITURA PËR KONFLIKT INTERESASH**

KSHPK ka pranuar 23 lëndë të reja nga fusha e konfliktit të interesave, siç vijon: nëntë lëndë me kërkesë të personit përgjegjës i cili udhëheq një organ; tri lëndë me kërkesë të personit zyrtar; tri lëndë në bazë të denoncimit të personave të tjerë; tri lëndë në bazë të denoncimit anonim; katër raste me kërkesë të personit tjetër fizik (personit zyrtar). Nga 23 lëndë të reja të hapura, kanë përfunduar shtatë (30) dhe te ata nuk është konstatuar gjendje e konfliktit të interesave, ndërsa për lëndët e tjera, procedura është në vijim.

Krahas rasteve të tjera, KSHPK vendoste edhe për 35 raste, të pranuar dhe të hapura muajve dhe viteve të kaluara.

KSHPK bëri shtatë ankesa kundër aktvendimeve të dorëzuara nga ana e Gjyqit Themelor Shkup I dhe të Gjykatës së Apelit.

IP 12**TËRËSIA DHE AKTUALITETI I TË DHËNAVE NGA REGJISTRI I PERSONAVE TË ZGJEDHUR DHE TË EMËRUAR**

Sipas të dhënave në gazetata zyrtare të Republikës së Maqedonisë, në periudhën e raportimit janë publikuar vendime për emërim dhe zgjedhje të 193 personave. Sipas ligjit, për të gjithë personat e emëruar dhe të zgjedhur, institucionet të cilat i kanë emëruar, në KSHPK në afat prej 15 ditëve duhet të dorëzojnë të dhëna për azhurnim të Regjistrimit për persona të zgjedhur dhe të emëruar. Gjatë kontrollit të të dhënave në regjistr, deri më 15 shkurt 2017, për 57 persona (30%) nuk janë publikuar të dhëna në regjistr.

Dorëzimi i të dhënave është obligim i institucioneve, por KSHPK, në pajtim me nenin 63-b, alineja 1, të Ligjit për parandalimin e korrupsionit, ka mundur të ngrjë iniciativë për procedura kundërvajtëse për mospërbushjen e obligimeve për dorëzimin e të dhënave të nevojshme për azhurnimin e Regjistrimit. Në bazë të kësaj, vënia gjobë për këtë akt kundërvajtës, në buxhetin e shtetit do të hynin 125.000 euro.

IP 13**VEPRIMI SIPAS DENONCIMEVE PËR FITIMIN E PJESËVE APO AKSIONEVE**

KSHPK nuk ka lëndë ndaj të cilës ka vepruar, e cila ka lidhje me fitimin e pjesëve apo aksioneve, sepse denoncime të tilla nuk ka pasur fare. KSHPK nuk ka vendosur një sistem të kontrollit për kufizimin pas largimit nga shërbimi.

IP 14**VEPRIMI SIPAS DENONCIMEVE TË PARAQITURA NGA ANA E QYTETARËVE APO NJË PERSONI JURIDIK, TË PAKËNAQUR NGA VENDIMI I SJELLË NË BAZË TË AUTORIZIMEVE DISKREZIONALE DHE TË CILËT KONSIDEROJNË SE KY VENDIM ËSHTË SJELLË PËR SHKAK TË KORRUPTIMIT**

Deri te KSHPK nuk janë dorëzuar denoncime të qytetarëve të pakënaqur nga vendimi i sjellë në bazë të autorizimit diskrecional dhe të cilët konsiderojnë se ky vendim është sjellë për shkak të korrupsionit.

INDIKATOR

TETORI - DHJETOR 2016

IP 15

NGRIT INICIATIVA PARA ORGANEVE KOMPETENTE PËR KONTROLL TË PUNËS FINANCIARE-MATERIALE TË SINDIKATËS

Sipas përgjigjes së paraqitur, KSHPK nuk ka ngritur iniciativa para organeve kompetente për kontroll të punës financiare-materiale të sindikatës.

IP 16

NGRIT INICIATIVA PARA ORGANEVE KOMPETENTE PËR KONTROLL TË PUNËS FINANCIARE-MATERIALE TË SHOQATAVE DHE FONDACIONEVE

KSHPK veproi në bazë të denoncimit të paraqitur nga ana e një pjesëmarrësi në procesin zgjedhor për dyshim për shfytëzimin e burimeve kundërligjore dhe anonime të financimit nga ana e një partie politike dhe dhënie ryshfet zgjedhësve¹. Në bazë të denoncimit, për 21 shoqata dhe fondacione, KSHPK kërkoi masa kompetente të Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë, kontrolle detale të punës së tyre financiare-materiale nga Drejtoria për të Hyra Publike dhe kontroll/ analizë financiare nga Drejtoria për Zbulim Financiar.

IP 17

AKTIVITETE DHE MASA TË NDËRMARRA NGA ANA E KSHPK SI PËRGJIGJE NDAJ DENONCIMEVE TË PARAQITURA NGA INFORMATORË PËR MOSSIGURIMIN E MBROJTJES SË TYRE

KSHPK nuk ka lëndë për të cilën ka vepruar, e cila ka lidhje me informatorët. Nuk ka informacione në dispozicion për numrin e institucioneve në të cilat nuk është emëruar një person për pranimin e denoncimeve të bëra për ndonjë denoncim të brendshëm të mbrojtur.

IP 18

NDËRMARRJE MASASH NË BAZË TË DENONCIMEVE NGA ANA E QYTETARËVE DHE PERSONAVE JURIDIK

Në periudhën e raportimit, KSHPK ka vepruar për 19 lëndë për ekzistimin e elementeve për korrupsion të cilat janë hapur në bazë të denoncimeve të qytetarëve, personave juridik apo me vetiniciativë. Nga këto raste janë zgjidhur 12 lëndë. Nuk ka informata në dispozicion për përmbajtjen e denoncimeve nga ana e qytetarëve dhe personave juridik.

3.3 BASHKËPUNIM DHE EDUKIM

Nëpërmjet edukatës së organeve kompetente për zbulimin dhe ndjekjen e korrupsionit dhe llojeve të tjera të krimit, KSHPK mund të kontribuojë në përforcimin e kapaciteteve të organeve të drejtorisë shtetërore. KSHPK ka obligim ligjor të ndërmarrë aktivitete në planin e edukimit të organeve kompetente për zbulimin dhe ndjekjen e korrupsionit dhe të gjitha iniciativave të tjera.

ÇFARË KA NDËRMARRË KSHPK NË FUSHËN E BASHKËPUNIMIT DHE EDUKIMIT NË PERIUdhËN PREJ 1 TETORIT DERI MË 31 DHJETOR 2016?

| INDIKATOR | TETORI - DHJETOR 2016 |
|---|--|
| IP 19 BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONE TË TJERA SHTETËRORE NË MAQEDONI DHE JASHTË | <p>Në periudhën e raportimit, KSHPK ka realizuar takim me shefin e Delegacionit të Bashkimit Evropian në Republikën e Maqedonisë. Me konferencën përfundimtare më 7 tetor 2016 e shënoi përfundimin e bashkëpunimit me Shërbimin Federal për Administratë nga Gjermania, në kuadër të projektit IPA Tuning “Përkrahje për preventivë efikase dhe luftë kundër korrupsionit”.</p> <p>Në periudhën e raportimit, KSHPK e intensifikoi bashkëpunimin me organet e tjera shtetërore, nga e cila pritet të dalë nënshkrimi i memorandumit për bashkëpunim me Drejtorinë për Zbatimin e Sanksioneve.</p> <p>Njëkohësisht, KSHPK filloi komunikimin me universitetet nëpër Maqedoni, në drejtim të nënshkrimit të memorandumeve individuale për bashkëpunim, me qëllim të zbatimit të edukatës kundër korrupsionit për studentët.</p> |
| IP 20 ZBATIMI I AKTIVITETEVE NË KUADËR TË MEMORANDUMIT PËR BASHKËPUNIM NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE ME SEKTORIN QYTETAR | <p>Në dhjetor 2016, KSHPK e pranoi iniciativën e QMBN për bashkëpunim gjatë realizimit të projektit të QMBN për “Ndjekjen e punës së KSHPK”, në kuadër të të cilit u hartua ky raport.</p> <p>Bashkëpunimi me organizata të tjera qytetare nuk u realizua.</p> <p>Nuk mbahen mbledhje të rregullta tremujore me nënshkruesit e Memorandumit, siç është paraparë në Programin Vjetor për Punën për vitin 2016.</p> |
| IP 21 ZBATIMI I AKTIVITETEVE NË KUADËR TË MEMORANDUMIT PËR BASHKËPUNIM NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KONFLIKTIN E INTERESAVE ME SEKTORIN PRIVAT | <p>Në periudhën në fjalë nuk janë realizuar aktivitete në pajtim me Memorandumin për bashkëpunim me sektorin e biznesit, edhe pse në Programin Vjetor për Punë për vitin 2016 është paraparë mbajtja e mbledhjeve të rregullta tremujore me nënshkruesit e Memorandumit.</p> |

INDIKATOR

TETORI - DHJETOR 2016

IP 22

AKTIVITETE TË NDËRMARRA
NË PLANIN E EDUKIMIT TË
ORGANEVE KOMPETENTE PËR
ZBULIMIN DHE NDJEKJEN E
KORRUPSIONIT DHE LLOJEVE
TË TJERA TË KRIMIT

Më 13 tetor 2016, KSHPK organizoi konferencë me temën: “Metoda të avancuara për monitorimin e financimit të partive politike dhe fushatave zgjedhore”. Në kuadër të planit për trajnime gjenerike në organizim të MIOA, më 31 dhjetor 2016 u mbajt trajnimi “Masa kundër korrupsionit dhe etika në shërbimet shtetërore”, në të cilin morën pjesë edhe përfaqësues të institucioneve dhe organeve për zbatimin e ligjit. Me qëllim të forcimit të kapaciteteve të Njësisë për Kontroll Kundër Korrupsionit të Legjislaturës dhe Institucioneve të Tjera Shtetërore dhe përfaqësues të sektorit qytetar, KSHPK në bashkëpunim me Inicativën Rajonale Kundër Korrupsionit (RAI) organizoi punëtori dyditore më 28 dhe 29 nëntor 2016 për kontrollin e legjislaturës.

4. TRANSPARENCA

Transparenca nënkupton qasje dhe ardhje deri te informatat lidhur me punën e KSHPK për publikun. Ç'janë obligime të përcaktuara ligjore (de jure) të KSHPK për sigurimin e transparencës?

KSHPK është i obliguar që rregullisht ta informojë publikun për masat dhe aktivitetet e ndërmarra dhe për rezultatet e punës së vet

KSHPK është i obliguar ta publikojë raportin vjetor në mjetet e informimit publik

KSHPK është i obliguar ta informojë publikun për raste të konfliktit të interesave për të cilat ai vepron

Ç'duhet të publikojë KSHPK për të siguruar transparencë të tërësishme të punës së vet, edhe pse nuk ka obligim ekspllicit ligjor (transparencë de fakto) për këtë gjë?

programe dhe raporte vjetore për punën e vet

informata për mbledhje të mbajtura të komisionit

Информации од одржани седници на комисијата

mendime të dhëna për propozim-ligjet pas kontrollit të kryer kundër korrupsionit të legjislaturës

informata për bashkëpunim të realizuar me organizatat qytetare

TRANSPARENCA DE JURE

INDIKATOR

TETORI - DHJETOR 2016

IT-2

QASJA DERI TE REGJISTRI ME PERSONAT E ZGJEDHUR DHE TË EMËRUAR

Qasje deri te Regjistri ekziston, por ka kufizim sa i përket shfletimit dhe qartësisë së regjistrit. Regjistri i personave të zgjedhur dhe të emëruar nuk ka "histori të ndryshimeve", e cila mundëson pasqyrë për fillimin dhe fundin e kryerjes së funksionit të çdo personi të zgjedhur dhe të emëruar. Nuk ka mundësi për t'u ruajtur e tërë baza e të dhënave me qëllim që të bëhet analiza/përpunimi kompjuterik i të dhënave. Regjistri nuk ka qasje në format të hapur, në pajtim me Ligjin për shfrytëzimin e të dhënave të karakterit publik.

INDIKATOR

TETORI - DHJETOR 2016

IT-3

FLETË ANKETUESE DHE SHKRESA PËR NDRYSHIM NË GJENDJEN PRONËSORE NË UEB-FAQEN E KSHPK

Në bazë të të dhënave në dispozicion në ueb-faqen data-mkopen, e cila i ndjek ndryshimet e bëra në bazë të të dhënave të fletëve anketuese, në periudhën prej 05.10.2016 deri më 03.01.2017, në bazë është bërë ndryshimi i 181 shënimeve të funksionarëve publik. Këto ndryshime përfshijnë edhe fletë anketuese të reja dhe shkresa për ndryshime të gjendjes pronësore. KSHPK ka lajmëruar se në periudhën prej 01.10.2016 deri më 31.12.2016 janë dorëzuar gjithsej 232 fletë anketuese. Dallimi prej 51 flete anketuese mund të jetë rezultat i periudhës së nevojshme për përpunimin nga ana e KSHPK dhe publikimin e tyre në ueb-faqe.

IT-6

PUBLIKIMI I INFORMATAVE PËR RASTET E KONFLIKTIT TË INTERESAVE NDAJ TË CILAVE VEPRON KSHPK DHE MASA DHE AKTIVITETE TË CILAT I KA NDËRMARRË

Janë publikuar gjithsej tri informata për masa dhe aktivitete të ndërmarra për konflikt të interesave. Me këto informata janë përfshirë gjithsej tre persona, në rangun e nivelit të ulët të korrupsionit.

IT-9

INFORMATA NË DISPOZICION PUBLIK PËR AKTIVITETET E KSHPK

Në periudhën e raportimit u publikuan gjithsej 18 informata në ueb-faqen e KSHPK, nga të cilat:

- Dy lajmërimet për shtyp;
- Tetë informata për seanca publike, duke përfshirë edhe rendin e ditës dhe vendime të sjella;
- Tri informata për aktivitete të ndërmarra, iniciativa dhe procedura të ngritura për kontrollin e rasteve me korrupsion apo konflikt interesash, si dhe informata për përgjigjet e fituara adekuate dhe përgjigjet e marra nga institucione të tjera të cilat paraprakisht kanë qenë të autorizuara të veprojnë nga ana e KSHPK;
- Dy informata për takime të mbajtura;
- Tri informata të tjera lidhur me raportet financiare nga zgjedhjet e parakohshme parlamentare.

KSHPK nuk publikon informata nga seancat e Komisionit, për të cilat nuk ka obligim ligjor të jenë publike.

TRANSPARENCA DE FAKTO

| INDIKATOR | TETORI - DHJETOR 2016 |
|--|---|
| IT-10 RAPORTE VJETORE TË PUBLIKUARA DHE PLANE PËR PUNËN E KSHPK PËR VITIN AKTUAL | Programi vjetor për vitin 2017 është publikuar në pdf format në pjesën e dokumenteve, jo edhe si lajmërim për publikun. |
| IT-11 INFORMATA NË DISPOZICION PËR MENDIMIN E KSHPK PËR PROPOZIME TË LIGJEVE TË RËNDËSISHME PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT | KSHPK nuk ka publikuar mendim të cilin e ka dhënë me propozim të ligjit për ndryshime të Ligjit për punë të brendshme, të hartuar me kërkesë të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Dokumenti për dhënien e mendimit nuk është në dispozicion në ueb-faqen e KSHPK. |
| IT-12 TRANSPARENÇË NË PROCESIN E KONTROLLIT KUNDËR KORRUPSIONIT TË LEGJISLATURËS (KKKL) | Nuk është publikuar një plan për dinamikën e kontrollit të KKKL. Plani në periudhën e kërkesës është në hartim e sipër. Nuk janë publikuar informata lidhur me KKKL. |
| IT-13 QASJE DERI TE FLETËT ANKETUESE DHE FLETËPARAQITJET PËR NDRYSHIME NË GJENDJEN PRONËSORE, TË PUBLIKUARA NGA KSHPK | <p>Kërkimi në ueb-faqe është i mundur me emër, mbiemër, funksion dhe institucion.</p> <p>Ueb-faqja nuk jep mundësi të ruhet e tërë baza e të dhënave apo pjesë të saj, me qëllim që të bëhet përpunimi kompjuterik i të dhënave.</p> <p>Të dhënat historike për fletët anketuese dhe për fletëparaqitjet për ndryshime në gjendjen pronësore janë në dispozicion deri në çastin e tërheqjes nga funksioni. Për publikun janë në dispozicion vetëm të dhënat për funksionarët aktual, gjegjësisht për ata që kanë dorëzuar fletë anketuese vetëm për zgjedhje, por jo edhe për përfundim. Pas dorëzimit të fletës anketuese për përfundimin e funksionit, të dhënat për këtë person në mënyrë automatike nuk janë më në dispozicion për publikun, por nuk fshihen nga baza e të dhënave të KSHPK.</p> <p>Në ueb-faqe nuk ruhet “historia e ndryshimeve” për çdo fletë anketuese, gjegjësisht për çdo person, me të cilën gjë nuk lejohet ndjekja e ndryshimeve për çdo shënim në veçanti. KSHPK në kuadër të tuining-projektit, përgatiti një zgjidhje të re softuerike, e cila për t’u zbatuar nevojitet një ndryshim ligjor dhe vendosje e dorëzimit të obligueshëm elektronik të fletëve anketuese.</p> |

INDIKATOR**TETORI - DHJETOR 2016****IT-14**

INFORMATA NË DISPOZICION PËR DENONCIME TË BËRA NGA ANA E QYTETARËVE APO PERSONAVE JURIDIK TË PAKËNAQUR ME NDONJË VENDIM TË SJELLË NË BAZË TË AUTORIZIMIT DISKRECIONAL

KSHPK nuk mban statistikë.

IT-15

QASJE DERI TE INFORMATAT SE A ËSHTË PUNËSUAR NDONJË PERSON ZYRTAR NË AFAT PREJ TRE VJET PAS PËRFUNDIMIT TË AUTORIZIMEVE APO OBLIGIMEVE PUBLIKE, GJEGJËSISHT PAS PËRFUNDIMIT TË PUNËSIMIT, NË NDONJË NGA SHOQATAT TREGTARE NË TË CILAT KA BËRË KONTROLL APO ÇFARËDO LLOJI RAPORTI ME MARRËVESHJE GJATË KRYERJES SË AUTORIZIMEVE DHE OBLIGIMEVE PUBLIKE

KSHPK nuk ka vendosur sistem për ndjekjen se a është punësuar ndonjë person zyrtar në afat prej tre vjet pas përfundimit të autorizimeve apo obligimeve zyrtare, gjegjësisht pas përfundimit të punësimit, në ndonjë shoqëri tregtare në të cilën ka bërë kontroll apo ka vendosur çfarëdo marrëdhënie me marrëveshje gjatë kryerjes së autorizimeve apo obligimeve publike.

IT-16

QASJE DERI TEK INFORMATAT PËR EKZISTIMIN APO MOSEKZISTIMIN E DENONCIMEVE PËR FITIMIN, NË ÇFARËDO BAZE, AKSIONE, GJEGJËSISHT PJESË NË PERSONIN FIZIK NË TË CILIN KA PUNUAR, GJEGJËSISHT KA BËRË KONTROLL PERSONI ZYRTAR, PAS PËRFUNDIMIT TË KRYERJES SË AUTORIZIMEVE DHE OBLIGIMEVE PUBLIKE

Deri te KSHPK nuk janë bërë denoncime në këtë bazë.

INDIKATOR**TETORI - DHJETOR 2016****IT-17**

QASJE DERI TE INFORMATAT PËR DENONCIME TË INFORMATORËVE PËR MBROJTJE TË PASIGURT NË INSTITUCIONIN ADEKUAT

KSHPK nuk ka pasur denoncime të këtij lloji edhe për shkak se nuk ka publikuar informata për ekzistimin apo mosekzistimin e denoncimeve nga ana e informatorëve për moshigurimin e mbrojtjes në një organizatë përkatëse.

IT-18

INFORMATA NË DISPOZICION PËR AKTIVITETE DHE MASA TË NDËRMARRA NGA ANA E KSHPK SI PËRGJIGJE NDAJ DENONCIMEVE TË MARRA NGA INFORMATORËT PËR MOSSIGURIMIN E MBROJTJES SË TYRE

Nuk ka informata të publikuara, për arsye se KSHPK nuk ka pasur denoncime të këtij lloji.

IT-19

QASJE DERI TE INFORMATAT NË UEB-FAQEN PËR BASHKËPUNIM ME INSTITUCIONE TË TJERA SHTETËRORE NË MAQEDONI DHE JASHTË

Për të gjitha aktivitetet sa i përket bashkëpunimit, KSHPK ka publikuar informata dhe lajmërimi në ueb-faqen e KSHPK. Bëhet fjalë për lajme të publikuara për takimin me shefin e Delegacionit të Bashkimit Evropian dhe shënimin e përfundimit të bashkëpunimit me Shërbimin Federal për Administratë nga Gjermania, në kuadër të projektit IPA Tuining "Përkrahje për preventivë efikase dhe luftë kundër korrupsionit".

IT-20

QASJE DERI TE INFORMATAT NË UEB-FAQE PËR BASHKËPUNIM ME ORGANIZATA QYTETARE

Nuk ka informata të publikuara, për shkak se KSHPK nuk ka pasur takime të realizuara me organizata qytetare.

IT-21

QASJE DERI TE INFORMATAT NË UEB-FAQE PËR BASHKËPUNIM ME SEKTORIN E BIZNESIT

Nuk ka informata të publikuara, për shkak se KSHPK nuk ka pasur takime të realizuara me sektorin e biznesit.

INDIKATOR

TETORI - DHJETOR 2016

IT-22

PREZANTIM I RREGULLT
I AKTIVITETEVE DHE
REZULTATEVE TË ARRITURA
PARA PUBLIKUT

Në bazë të të dhënave në dispozicion në ueb-portalin www.time.mk, janë publikuar gjithsej 92 lajme. Lajmet të cilat i kanë publikuar mediet në të shumtën e rasteve përmbajnë informata për paralajmërim dhe mbajtje të seancave publike të Komisionit, konferenca etj. Gjithashtu, për shkak të mbajtjes së zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, në lajme janë përfshirë edhe informata për ndërmarrje veprimi të KSHPK rreth denoncimeve të paraqitura dhe lëndëve të hapura për parandalimin e korrupsionit në procesin zgjedhor.

Numri i leximit të lajmeve (33) për të cilat ekziston numërori është 26.637.

IT-23

QASJA DERI TE INFORMATAT
NGA SEANCAT E MBAJTURA
TË KOMISIONIT

Në ueb-faqe janë publikuar 13 informata për mbajtjen e tri seancave publike të Komisionit, edhe atë më 01.02.2016, më 07.12.2016 dhe më 09.12.2016.1

Mbajtja e seancave publike është obligim i KSHPK kur vepron rreth denoncimeve të paraqitura për mosrespektimin e ndalesës së shfrytëzimit të mjeteve buxhetore gjatë zgjedhjeve, punësime apo shfrytëzimin e hapësirave, pajisjes dhe automjeteve zyrtare të institucioneve për fushatë zgjedhore.

Për seancat e mbajtura më 01.12.2016 dhe 07.12.2016 janë publikuar paralajmërime për mbajtjen e seancës publike, me rendin e ditës së seancës. Nga seancat publike, janë publikuar edhe vendimet e marra.

Për seancat e tjera të mbajtura për të cilat nuk ka obligim ligjor, KSHPK nuk publikon informata në ueb-faqe.

5. LLOGARIDHËNIE

Llogaridhënia e KSHPK si i pavarur në kryerjen e kompetencave të veta, sigurohet në rast se ai punon në interes të publikut dhe pengohet apo zbutet puna potenciale për interesa personale. Llogaridhënia nuk nënkupton vetëm “llogaridhënie vertikale”, gjegjësisht përgjegjësi hierarkike para një institucioni tjetër, por edhe më e rëndësishme është e ashtuquajtura “llogaridhënie horizontale”. Ajo përfshin ndjekjen nga ana e palëve të tjera të prekura, mes të cilave edhe qytetarët, kështu që rritja e llogaridhënies para qytetarëve është njëri nga mekanizmat kyç për avancimin e llogaridhënies së tërësishme të KSHPK.

SA KSHPK KA BËRË LLOGARIDHËNIE NË PERIUdhËN NGA 1 TETORI DERI MË 31 DHJETOR 2016?

| INDIKATOR | TETORI - DHJETOR 2016 |
|--|--|
| IO 5 Lloji i informatave të cilat KSHPK ua ka dërguar medieve publike elektronike dhe të shtypura për aktivitetet dhe rezultatet e saj | <p>KSHPK medieve u ka dërguar 17 lajmërimet për publikun, por prej tyre vetëm dy janë publikuar në ueb-faqe, edhe pse ekziston pjesë e posaçme (“Marrëdhënie me Publikun”) e paraparë për këtë qëllim.</p> |
| IO 6 Veprimi ndaj kërkesave për qasje deri te informatat e karakterit publik | <p>Të vlerësohet përfshirja e përgjithshme e informatave të cilat i dërgon KSHPK deri te kërkesuesit e informatave të karakterit publik, të cilat janë përfshirë në Listën e Informatave të Karakterit Publik, të cilin e posedon KSHPK, u kërkuar 15 informata nga 29, sa janë përfshirë në Listë. Informatat e kërkuar kanë të bëjnë me periudhën tetor-dhjetor 2016.</p> <p>Përgjigjet ndaj nëntë pyetjeve ishin të plota dhe i përgjigjen përshkrimet nga lista. Tri përgjigje ishin të pjesshme, gjegjësisht informatat e dhëna nuk përgjigjen me përshkrimin e paraqitur në listë. Kështu, për shembull, edhe pse shkruan se emri dhe mbiemri i personave të cilët kanë dorëzuar fletëparaqitjet për ndryshim në gjendjen pronësore dhe emri dhe mbiemri i personave kundër të cilëve është ngritur iniciativë për hetimin e gjendjes pronësore janë informata të karakterit publik, ata nuk u dorëzuan.</p> <p>Për dy informata, përgjigjja e KSHPK është se ata nuk kanë në dispozicion të dhëna lidhur me informatën të cilën e përmban Lista.</p> <p>Për një informatë është theksuar se neni i ligjit është shfuqizuar dhe kjo informatë nuk është në dispozicion për periudhën për të cilën ka të bëjë kërkesa.</p> <p>Në periudhën nga tetori deri në dhjetor 2016 u dorëzuan dy kërkesa për qasje deri te informata të karakterit publik. Një kërkesë është zgjidhur pozitivisht, ndërsa për një tjetër është kërkuar plotësim i kërkesës dhe pastaj kërkesa e plotësuar është refuzuar. Kërkesa në të cilën është dhënë përgjigje pozitive kishte të bëjë me kontaktin e një nëpunësi të KSHPK, i cili vepron në bazë të ankesave dhe propozimeve në pajtim me Ligjin për veprim ndaj ankesave dhe propozimeve.</p> |

107

SHFRYTËZIMI I MEDIËVE
SOCIALE PËR NDARJEN E
INFORMATAVE ME PUBLIKUN

KSHPK nuk shfrytëzon asnjë nga mediet sociale për ndarjen e informatave me publikun.


5.1 MENDIMI I QYTETARËVE PËR KSHPK

Me qëllim që të vlerësohen qëndrimet e qytetarëve për KSHPK, u realizua një anketë telefonike me ekzemplar prej 1.300 të anketuarve. Anketa kishte për qëllim të vlerësohet se a e dinë qytetarët ç'është KSHPK, cilat janë kompetencat e tij ligjore, ç'mendojnë për efikasitetin e tij, transparencën dhe llogaridhënien.

A E DINË QYTETARËT Ç'ËSHTË DHE Ç'PUNON KSHPK?


Se ekziston KSHPK kanë dëgjuar 68,1% të të anketuarve. Nga këta, 35% për herë të parë kanë dëgjuar për KSHPK para një viti, ndërsa 32,8% për herë të parë kanë dëgjuar për KSHPK para më shumë se 5 vjet. Numri më i madh i qytetarëve KSHPK e njohin nga informatat të cilat i kanë marrë nëpërmjet televizionit dhe radios (79,4%), pasojnë mediet on-line (17,20%) dhe nga botimet ditore dhe javore (15,10%).

Grafiku 1. Ku keni dëgjuar dhe si keni fituar njohuri për KSHPK?



Nga hulumtimi del se më shumë se gjysma e qytetarëve (57,1%) fare nuk kanë njohuri për atë se ç'punon KSHPK.¹ Vetëm 4,5% të qytetarëve kanë njohuri të plota, ndërsa 37,7% dinë deri diku për punën e KSHPK. Nga përgjigjet dhe pyetjet për atë se cilat janë aktivitetet konkrete të cilat duhet t'i ndërmarrë KSHPK, mund të konstatohet se qytetarët nuk e njohin KSHPK dhe cilat janë kompetencat e tij. Më së shumti qytetarë (89%) e dinë se obligimi i KSHPK është ta mbajë Regjistrin e Personave të Zgjedhur dhe të Emëruar. Gjithashtu, 71% të qytetarëve e dinë se në mënyrë anonime mund të denoncojnë në KSHPK raste për të cilat dyshojnë se ekziston korrupsion. Nga ana tjetër, se KSHPK mund të ngrejë iniciativa për kontroll të punës financiare-materiale të shoqatave dhe fondacioneve, qytetarët pothuajse fare nuk dinë, sepse 15,2% janë përgjigjur se kjo është një nga kompetencat e Komisionit. Kompetencat e tjera të KSHPK i kanë njohur prej 50 deri në 60% të qytetarëve.


Grafiku 2: Njohja e kompetencave të KSHPK nga ana e qytetarëve



Ç'MENDOJNË QYTETARËT PËR KSHPK?


Sipas qytetarëve, tre institucione të cilat më së shumti kontribuojnë në luftën kundër korrupsionit në Maqedoni janë Ministria e Punëve të Brendshme, Këshilli Gjyqësor dhe Prokuroria Speciale Publike. KSHPK është në vendin e pestë sipas numrit të të anketuarve (11,94%) të cilët e kanë përmendur si institucion i cili kontribuon në luftën kundër korrupsionit.

Grafiku 3. A kontribuojnë institucionet shtetërore në Maqedoni në luftën kundër korrupsionit?



Në rast se janë viktimë të ndonjë rasti të korrupsionit, gati gjysma e qytetarëve (47%) rastin do ta kishin paraqitur në polici. Çdo i pesti qytetar (21%) rastin nuk do ta kishte paraqitur në asnjë institucion shtetëror. Pas policisë, KSHPK është institucioni i radhës në të cilin qytetarët e kishin paraqitur rastin (12%).

Grafiku 4. Ku do ta paraqisnin qytetarët rastin e korrupsionit, në rast se bëhen viktimë të ndonjë rasti të korrupsionit?




Ç'MENDOJNË QYTETARËT PËR LLOGARIDHËNIEN E KSHPK NDAJ TYRE?


Sipas 69% të qytetarëve, në medie nuk ka informata të mjaftueshme për KSHPK, ndërsa 67% konsiderojnë se informatat të cilat janë në dispozicion në medie nuk u mundësojnë të informohen për punën e KSHPK. Qytetarët shumë rrallë e vizitojnë ueb-faqen e KSHPK. Madje 83,2% të qytetarëve kurrë nuk e kanë vizituar faqen, ndërsa 7% vetëm një herë. Në bazë të rregullt ditore, javore dhe mujore, ueb-faqen e vizitojnë 9,4% të qytetarëve.

Të pyetur ta vlerësojnë efikasitetin e KSHPK, gjysma e qytetarëve, gjegjësisht 50,1% e vlerësojnë si joefikas, ndërsa 38,7% të qytetarëve konsiderojnë se është efektiv.

Grafiku 5. Mendimet e qytetarëve për efektivitetin e KSHPK



Në pyetjen në interes të kujt punon KSHPK, një numër i lartë i qytetarëve (61%) konsideron se me punën e vetë KSHPK i mbrojnë interesat e individëve (interes privat të politikanëve, të personave të zgjedhur dhe të emëruar), përkundër 28% të qytetarëve të cilët konsiderojnë se i mbrojnë interesat e qytetarëve (interesin publik).



6. KONKLUSIONE

Nga gjithsej 25 indikatorë të ndjekur në periudhën e raportimit, për të cilët ndiqet përmbushja e obligimeve ligjore (“ngjyrosja e indikatorëve”), 15 realizohen në tërësi në pajtim me ligjin, nëntë realizohen pjesërisht, ndërsa një nuk realizohet.

Aktivitetet e KSHPK u drejtuan drejt dhënies së mendimit për përdorimin e dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit në periudhën zgjedhore. Për shkak të kohëzgjatjes së madhe të periudhës zgjedhore dhe vendosjes së qeverisë kalimtare në shtator 2016 dhe zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të mbajtura më 11 dhjetor 2016, aktivitetet e KSHPK në tremujorin e fundit të vitit 2016, në pjesën më të madhe u drejtuan drejt përmbushjes së kompetencave të cilat dalin nga Ligji për Parandalimin e Korrupsionit – në pjesën e parandalimit të korrupsionit në politikë dhe Kodit Zgjedhor. KSHPK ka hapur gjithsej 1.548 lëndë, nga të cilat 1.526 me kërkesë për mendime të institucioneve për përdorimin e dispozitave të Ligjit për parandalimin e korrupsionit, 11 me denoncime të partive politike, 1 me denoncim të një

shoqate, 6 me denoncim të personave juridik (ministri dhe komuna), 2 të një personi fizik dhe 2 në bazë të lëndëve të formuara me iniciativë të KSHPK. Një pjesë e kërkesave për mendim të institucioneve kanë qenë të lidhur me zbatimin e procedurave për furnizime publike, për pagesa të jashtëzakonshme të mjeteve buxhetore apo të fondeve dhe të pasurit në dispozicion të mjeteve buxhetore në nivel qendror dhe lokal.

KSHPK nuk ka vendosur mekanizma për ndjekjen e mospërmbushjes së obligimeve të cilat dalin nga kompetencat për mbajtjen e Regjistrit dhe fletët anketuese të personave të zgjedhur dhe të emëruar, të cilët kanë të bëjnë me institucionet dhe me personat e zgjedhur dhe të emëruar. Në bazë të të dhënave të publikuara në Gazetën Zyrtare, janë emëruar 193 persona në funksione. Nga ata, për 32 (16%) persona nuk ka informata të publikuara as në Regjistrin për të zgjedhur dhe të emëruar, as në bazën për gjendjen pronësore, ndërsa për 25 (13%) persona nuk ka informata vetëm në Regjistër, ndërsa është publikuar në fletët anketuese, ndërsa për tre (2%) ka informata në Regjistër dhe nuk kanë publikuar fletë anketuese. KSHPK ka mundur dhe nuk ka ngritur iniciativa para gjyqit kompetent për t'i vënë gjoba institucionit apo personit publik nga institucioni i cili nuk ka dorëzuar të dhëna të nevojshme për azhurnimin e Regjistrit.

KSHPK ka ndërmarrë aktivitete për forcimin e kapaciteteve për zbatimin e kontrollit kundër korrupsionit në legjislativë (KKL). Fokusi i aktiviteteve është në forcimin e kapaciteteve. KSHPK për të punësuar në Sekretariat, për përfaqësues të institucioneve të tjera shtetërore dhe për organizata qytetare, organizon punëtori në këtë temë. Në tremujorin e fundit të vitit 2016, KSHPK nuk ka miratuar një plan dhe dinamikë të posaçme për vitin 2017 për zbatimin e kontrollin kundër korrupsionit në legjislativë në bazë të ligjeve të cilat veç më janë sjellë, i cili është në fazë të hartimit. Për shkak të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare dhe funksionimit të qeverisë kalimtare, nuk kishte as propozim-ligje të reja për të cilat KSHPK do të hartonte kontroll kundër korrupsionit. Për shkak të kësaj, zbatimi aktiv i KKL për propozim-ligje pritet pas formimit të qeverisë së re.

KSHPK i përmbush obligimet ligjore për transparencë. Nga 37 seanca të mbajtura, tri kanë qenë publike dhe për to u publikuan të gjitha informatat, duke pasur parasysh se KSHPK ka obligim ligjor për këtë. Për seancat e tjera të mbajtura nuk kishte informata të publikuara, duke përfshirë edhe informata për rendin e ditës dhe vendimet e sjella. KSHPK rregullisht e azhurnon bazën për gjendjen pronësore të personave të zgjedhur dhe të emëruar, por nuk janë në dispozicion të dhënat historike, me të cilën gjë do të ndiqej ndryshimi i gjendjes pronësore të personave të zgjedhur dhe të emëruar. Në periudhën e ndjekjes, KSHPK nuk ka publikuar mendim të dhënë në lidhje me një propozim të një ligji për ndryshimin e Ligjit për punë të brendshme.

Një pjesë e përgjigjeve të cilat i dërgon KSHPK për kërkuesit e informatave të karakterit publik, nuk përgjigjen në tërësi me përshkrimet e paraqitura në Listën e informatave të karakterit publik, të cilën e ka në dispozicion KSHPK. Edhe pse në Listë shkruan se informatë me karakter publik është numri i rasteve për të cilat ka vepruar KSHPK, në të cilat funksionarë e kanë keqpërdorur pozitën e vet për shkak të realizimit të dobisë për vete apo për dikë tjetër, KSHPK thotë se nuk ka në dispozicion informata të këtij lloji. Gjithashtu, edhe pse theksohet se emri dhe mbiemri i personave kundër të cilëve është ngritur iniciativë për kontrollin e gjendjes pronësore janë informata të karakterit publik, ata nuk u dorëzuan. Për informatat për të cilat në përshkrim ka të dhëna statike, janë dorëzuar vetëm numrat e përgjithshme, pa analizë plotësuese.

Qytetarët nuk janë të njoftuar mjaftueshëm për punën e KSHPK. Se ekziston KSHPK, kanë dëgjuar 68,1% qytetarë, ndërsa më shumë se gjysma e qytetarëve (57,1%) fare nuk janë njoftuar me atë se çfarë punon KSHPK. Numri më i madh i qytetarëve janë të njoftuar me kompetencat e KSHPK për ta mbajtur Regjistrin e personave të zgjedhur dhe të emëruar (89%). Njëkohësisht, 71,8% të qytetarëve e dinë se mund të denoncojnë në mënyrë anonime deri te KSHPK raste për të cilat dyshojnë se ekziston korrupsion. Por, një numër shumë më i vogël (50-60%) kanë njohuri për kompetenca të tjera të KSHPK, më së paku (15,2%) kanë njohur për atë se KSHPK mund të ngritë iniciativa për kontrollin e punës financiare-materiale të shoqatave dhe fondacioneve. Qytetarët shumë rrallë e vizitojnë ueb-faqen e KSHPK. Madje 83,2% të qytetarëve kurrë nuk e kanë vizituar faqen. Sipas 69% të qytetarëve, në medie nuk ka informata të mjaftueshme për paraqitjen e punës së KSHPK.

7. REKOMANDIME

KSHPK duhet të ndërmarrë aktivitete për avancimin e rolit preventiv të KSHPK nëpërmjet masave proaktive për inicimin e procedurave për zbardhjen e keqpërdorimeve të mundshme të mjeteve buxhetore dhe fondeve publike gjatë fushatave zgjedhore apo në përgjithësi për financimin e zgjedhjeve apo aktiviteteve të tjera politike. Gjatë procesit zgjedhor, KSHPK duhet t'i ndjekë, të reagojë dhe të prononcohet për gjetjet për keqpërdorime potenciale për shfrytëzimin e mjeteve publike në fushat zgjedhore të publikuara në medie.

Në kuadër të sistemit të vendosur për evidentimin e personave të zgjedhur dhe të emëruar – kompetencë e KSHPK për ta mbajtur Regjistrin për të zgjedhur dhe të emëruar, nevojitet që KSHPK ta zhvillojë mekanizmin për ndjekjen e mosplotësimit të obligimeve që dalin nga kompetencat për mbajtjen e Regjistrit të personave të zgjedhur dhe të emëruar. Në këtë mënyrë do të sigurohet ndërmarrja më e shpejtë e masave të cilat janë në dispozicion.

KSHPK duhet t'i intensifikojë aktivitetet për instalimin e sistemit për ndjekjen e gjendjes pronësore të personave të zgjedhur dhe të emëruar me paraqitje historike, për të cilën gjë është i domosdoshëm ndryshimi i Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit. Krahas azhurnimit të rregullt të bazës për gjendjen pronësore të personave të zgjedhur dhe të emëruar, duhet të vendoset një lidhje elektronike mes Regjistrit për persona të zgjedhur dhe të emëruar dhe bazës së të dhënave nga fleta anketuese, por nuk janë në dispozicion të dhënat historike, me të cilën gjë lehtë do të ndiqej ndryshimi në gjendjen pronësore të personave të zgjedhur dhe të emëruar.

Duhet të miratohet plani dhe dinamika për vitin 2017 për realizimin e kontrollit kundër korrupsionit të legjislaturës rreth ligjeve të cilat veç më janë sjellë. Në kushte të funksionimit të qeverisë kalimtare, e cila nuk mund të propozojë sjelljen e ligjeve të reja, duhet të bëhet një analizë për ekzistimin e rrezikut nga korrupsioni në numrin më të madh të ligjeve të sjella.

KSHPK duhet ta vazhdojë dhe ta intensifikojë bashkëpunimin veç më të vendosur me organet e tjera shtetërore, me shoqata dhe fondacione dhe me sektorin privat, në drejtim të organizimit të takimeve, debateve, trajnimeve dhe punëtorive të rregullta.

KSHPK duhet t'i intensifikojë aktivitetet për informimin e publikut më të gjerë për efektet nga puna e KSHPK. E nevojshme është mbajtja e konferencave për shtyp, deklarata për gazetarët, brifingje, informim elektronik. KSHPK duhet ta përmirësojë transparencën edhe me publikimin e informacioneve të cilat nuk i ka si obligim ligjor, me publikimin e informatave nga seancat e mbajtura, masat e ndërmarra për kontroll të personave të zgjedhur dhe të emëruar, mendimet e bëra për ligjet kundër korrupsionit etj. Mediet sociale, si facebook-u, janë një mjet për qasje të drejtpërdrejtë deri te qytetarët dhe KSHPK duhet ta shqyrtojë mundësinë për vendosjen e një faqeje facebook-u, në të cilën do t'i publikojë informatat për aktivitete të ndërmarra dhe masa për punën e vet.

Duhet që KSHPK ta azhurnojë dhe rishqyrtojë Listën e informatave të karakterit publik. Informatat të cilat i ka në dispozicion KSHPK duhet të fshihen nga lista dhe për informatat të cilat nuk janë më aktuale për shkak të anulimit të një neni të caktuar të ligjit, duhet të shënohet në listë deri më datën në të cilën këto informata janë në dispozicion. Gjithashtu, duhet të plotësohen edhe informata të reja të cilat i ka në dispozicion KSHPK, të cilat dalin nga Ligji për mbrojtjen e informatorëve apo ndryshime të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesave, të bëra pas publikimit të Listës. Për informata të vendosura në Listë, për të cilat KSHPK bën me dije se nuk i ka në dispozicion, duhet të vendoset një sistem për grumbullimin e tyre.

8. BIBLIOGRAFIA

LIGJE

Ligji për parandalimin e korrupsionit (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 28/2002, 46/2004, 126/2006, 10/2008, 161/2008, 145/2010, 97/2015, 148/2015)

Ligji për konflikt të interesave (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 28/2002, 46/2004, 126/2006, 10/2008, 161/2008, 145/2010, 97/2015, 148/2015)

Ligji për mbrojtjen e informatorëve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 196/2015)

Udhëzues për bashkëpunim me organet e drejtorisë shtetërore, ndërmarrjet publike, institucionet publike dhe personat e tjerë juridik të cilët kanë në dispozicion kapital shtetëror me Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 81/2004 и 135/2006)

DOKUMENTE DHE PROGRAME STRATEGJIKE

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (2015). Metodologjia për kontroll kundër korrupsionit të legjislaturës. Në dispozicion në:

www.dksk.mk/fileadmin/PDF/Metodologjia_za_APL.pdf

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (2016). Programi për punën e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit për vitin 2016. Në dispozicion në:

<http://www.dksk.org.mk/images/stories/pdf/mislenje/programa%20za%20rabota%20dksk.pdf>

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (2017). Programi për punën e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit për vitin 2017. Në dispozicion në:

https://www.dksk.mk/fileadmin/PDF/Programa_za_rabota_2017/Programa_za_rabota_na_DKSK_za_2017.pdf

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (2015). Programi shtetëror për preventivë dhe represion të korrupsionit dhe Preventivë dhe ulje të dukurisë së konfliktit të interesave, me plan aksional 2016 – 2019. Në dispozicion në:

https://www.dksk.mk/fileadmin/Drzavni_programi/Drzavna_programa_2016-2019.pdf.

ANALIZË

Mangova I. (2013). A sjell rezultate modeli kundër korrupsionit në Maqedoni? Faktorë kyç të cilët e bëjnë një model të suksesshëm. Shkup: Instituti për Demokraci Societas Civilis – Shkup.

www.academia.edu/3081031/Is_the_Anti-Corruption_Model_Delivering_Results_in_Macedonia

BURIME TË TJERA

OpendataMacedonia <https://data-mkopen.rhcloud.com/>

Time.mk www.time.mk

